

NJOFTIM
Nr. 23304, datë 18.12.2019

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE, NË ADMINISTRIM TË BASHKISË KUKËS

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, kapitulli III, pika 16, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Bashkisë Kukës

Nr.	Emërtimi i objektit	Vend-ndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Salla e mbledhjeve, kati përdhes	Kukës	4 298 912	3 689 412	609 500	243.8	209.9	30.12.2019	09:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik, i interesuar për blerje me ankand, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare, në original, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë, për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.

3. Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. Dëshminë e trashëgimisë, prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.

5. Deklaratë noteriale, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfutur kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë

çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë: www.financa.gov.al